

محمد

El Konej

الله

NUMËR: 5, VITI I V PRISHTINË, MAJ-KORRIK 1979



Rëndësia e namazit

Një ndër shtyllat e besimit islamë është edhe kryerja e namazit. Këtë e argumenton, si Kur-ani ashtu edhe hadithi. Namazi është lidhshmëri e drejtë për drejtë e Zotit dhe njeriut, është dritë e cila ndriçon, argument i besimit të njeriut dhe mënyrë e shpëtimit. Bukur e shohim këtë nga hadithi vijues:

»Ai që i ruen kohët e namazit, ato për ate do të jenë dritë dhe argument i shpëtimit në ditën e gjykimit«.

Pejgamberi a. s. nuk lejoi kursesi të lehet namazi pa marrë parasysh kushtet me të cilat gjendet njeriu... duke iu përmbajtur versetit Kur-anor: **In-nes-salate kanet alal muëminine kitaben mevkuta.**

»Namazi është për besimtarët obligim të falet në kohë të caktuar«. Perëndia ka urdhëruar në disa vende në Kur-an që të falet namazi, duke iu tërheq vërejtjen atyre të cilët nuk e falin: **Ma selekekum fi sakarin kalu lem neku minel musal-line ve lem neku nutimul miskine.**

»Do të pyeteni çka u pruni në skëter (xhehenem); ata thonë: nuk jemi falur e as nuk i kemi ushqyer të varfurit«.

Namazi u bë farz në natën e Miraxhit: **Ve reva ubadetu ibni samiti radi All-llahu anhu en-nen-nebij-je sal-lallahu alejhi ve sellem kale: hamsu salevatin ketebehun-ne lla-hu alal ibadi. Fe men xhae bihin-ne lem judaj-jie minhun-ne shej-en istihfafen bihak-ki hin-nekane lehu indall-llahi ahdun en judhilehul xhen-nete, ve men lem jeëti bihin-ne felejse lehu indall-llahi ahdun in shae adh-dhebehu ve in shae edhalehul xhen-nete.**

»Dhe transmetohet nga Ubadete ibni Samiti i cili transmeton nga Muhamedi a. s. se ai ka thënë: »Zoti xh. sh. i ka bërë obligim 5 kohë të namazit për robët e vet, e ai që i kryen ato pa humb as gjë prej tyre, Zoti xh. sh. ka dhënë bespër te ta shtijë në xhen-net; e ai që nuk i kryen ato, për ate nuk ka besë, në dashtë e mundon e në dashtë e shtin edhe ate në xhen-net«.

Namazi është vepër më e dashur te Zoti xh. sh. pas imanit. Këtë na e vërteton edhe hadithi të cilin e transmeton Omer ibni Hatabi, i cili thotë se erdhë një njeri ke Pej-

gamberi a. s. dhe e pyeti: **Ej-jul ameli ehab-bu ilall-llahi teala fil islami? Kale: es-salatu ala vaktiha.**

»Cila vepër është më e dashur te Zoti i madhruar? Muhamedi a. s. tha: Namazi në kohën e vet«.

Hadithi vijues thekson: »Së pari do të pyeten njerëzit për namaz nëse i pranohet edhe ai dhe veprat tjera pranohen«. Më lartë theksuam se namazi është lidhshmëri e njeriut drejtë përdrejtë me Zotin, e më së afërmi është në sexhde. Për këtë Pejgamberi a. s. ka thanë: **Idha karee ibnu ademus-sexhede fesexhede iëtezelesh-shejtanu-ve jekulu: Ja vejlahu umire hadha bis-suxhudi fese-xhede felehul xhen-netu ve umirtu e-ne bis-suxhudi fe asajtu felijen-naru.**

»Kur të lexoj njeriu (kur të bëj sexhde) largohet shejtani, qanë duke thënë, vallë për mua, ky u urdhërua të bëjë sexhde dhe bëni. Për të është xhen-neti (e fitoi), e unë u urdhërova të bëj sexhde por bëra mëkat (nuk bëra sexhde) për mua është zjarri«.

Ne muslimanët jemi të urdhëruar që edhe fëmijtë tanë t'i mësojmë dhe urdhërojmë për namaz që nga vegjëlja. Pejgamberi a. s. ka thënë: **Muru evladekum bi s-salati ve hum ebnau sebi sinine ve idribu hum alejha ve hum ebnau ashri sinine.**

»Urdhëroi fëmijtë e juaj për namaz, kur ata janë në moshën 7 vjeçare dhe rrahni ata (nëse nuk dëgjojnë) në moshën 10 vjeçare«.

Pra namazi nuk guxon të lëshohet kurrësesi, por edhe ate që e bëjnë duhet ta kryejmë me të gjitha rregullat, se përndryshe nuk vlen.

Muhamedi a. s. ka thënë:

»Zoti xh. sh. nuk e shikon namazin e atij që nuk e ka zemrën së bashku me trup«. Ajshja r. a. thekson: Pejgamberi bisedonte me ne dhe ne — me te gjer sa vinte koha e namazit, atëherë ai bëhej sikur nuk na njeh fare, e as nuk e njohim fare ne ate, angazhohej me madhërin e Zotit xh. sh. Aliu r. a. me rastin kur u ther nga Abdurahman ibni Mulxhem Harixhiu, nuk lejonte të ia mjekojnë plagët nga dhembjet e mëdhaja që i kishte, e kur vinte koha e namazit u thote: tash bëni si të doni, se unë nuk dëgjoj dhembje gjer sa të dalë nga namazi«.

Nga lënda e Imamtit
Nexhat Ibrahim kl. V.



وَمَوْلَا الْقَلْبِ فَوْقَ عِبَادَةِ

Rëndësia e diturisë në islamizëm

Legjislacioni hyjnor, për herë të fundit iu shpallë njeriut nëpër mjet të dërguarit të fundit — Muhamedit a. s.

Ky qe ligji qiellor dhe botërorë, i cili i udhëzoi pjesëtarët e vet për shumë gjëra, në mes tjerash: marrëdhëniet ndërnjerëzore, jetën fetare, kërkimin e diturisë etj. Pra, kërkimi i diturisë është detyrë e domosdoshme e çdo muslimani. Në lidhje me këtë duhet të cekim hadithin e Muhamedit a. s. **Efdalul ibadeti talebul ilmi**

»Adhurimi më i vlefshëm është kërkimi i diturisë«.

Me të vërtetë dituria aktivizon dhe përqëndron personalitetin njerëzor si dhe besimin, andaj nuk mund të gjejmë mjet të tjetër më të fuqishëm për mbrojtjen dhe zhvillimin e njeriut se sa diturinë.

Zoti xh. sh. i don dhe i dallon dijetarët nga të paditurit e këtë mund ta vërtetojmë nga ky verset i Kur-anit famë lartë: **Kul hel jestevil-ledhine ja' lemune vel-ledhine la ja' lemune.**

»Thuaj (O Muhamed) a janë të barabarët ata të cilët dijnë me ata të cilët nuk dijnë«.

Në rrethet e kulturuara-civilizuara njerëzit paguajnë sqaruesit për mësim e dituri. Kurse në disa rrethet konzervative edhe pse shkollimi është pa parë, ata largohen nga dituria.

Një filozof ka thënë: »Dallimi në mes të diturve dhe të pa diturve është sikur të djallet me të vdekurit«. Zoti xh. sh. në Kur-an thekson: **Ve ma jestevil ae ma vel besiru ve ledh-dhulumatu ve len-nuru ve ledh-dhilu ve lel haruru ve ma jestevil ahjau. In-nall-lahe jusmiu men jeshau ve ma ente bi musmein men fil kuburi.**

»Të verëbrit dhe ai që sheh nuk janë të njejtë. Erësirat e drita nuk janë një. Nuk është e njëjtë as nxehtësia me ftohësinë. Nuk janë të njëjtë as të gjallët me të vdekurit. Vërtet e Zotin xh. sh. e dëgjojnë ata që iu është dhënë shqisat e të të dëgjuarit; e ti nuk mund të bëjsh që ata të cilët janë në varrë të të dëgjojnë prej varit«.

Këto janë disa krahasime në mes të diturve dhe të pa diturve. Për rëndësinë që i kushton kur-ani diturisë dhe dijetarëve mund ta vëjmë nga verseti vijues: **Jerfull-llahul-ledhine amenu min kum vel-ledhine utul ilme derexhatin.**

»Zoti i ngrit lartë ata të cilët besojnë prej jush dhe atyre të cilëve iu ka dhënë dituri«.

Gjersa Zoti xh. sh. thotë se njësinë e Tij e dëshmojnë engjujtë e njashtu edhe dijetarët. Këtë e vëjmë nga ky verset: **Shehidall-lahu en-nehu la ilahe il-lahu vel melaiketun ve ulul ilmi kaimen bil kisti.**

»Dëshmon Zoti se vërtet ai është Një, këtë e dëshmojnë edhe engjujtë dhe dijetarët e drejtë«. Nga ky verset shihet se Perëndia dëshminë e dijetarit e krahason me të Vetën dhe të engjujtë.

Njeriu islam nuk guxon ta mësoi vetëm shkencën islame, por të gjitha ato që janë të dobishme për shoqinë, në emër të Zotit. Gabojnë disa njerëz që mendojnë se egzistojnë dy lloj diturish, ajo fetare dhe e botës. Shkenca fetare nuk është e mjaftuar, prandaj edhe Muhamedi a. s. e urdhëroj rrept mësimin e shkencave pa marrë parasysh se çfarë është. Kur njeriu meret me shumë shkenca, më lehtë do ta përsosi anën fizike dhe psikike. Muhamedi a. s. ka thënë: **Likuli shejcin tarikun ve tarikul xhen-netil ilmi.**

»Çdo gjë ka drejtimin (rrugën) e saj, kurse drejtimi kah xhen-neti është dituria«. Në disa vërsete të Kur-anit shohim se Perëndia i urdhëron besimtarët e Tij për kërkimin e diturisë, për udhëzimin në rrugë të drejtë dhe në shpëtim, sikur që e shohim citatin Kur-anor: **Ve kul rab-bi zidni ilma.**

»Dhe thuaj o Zotë shtoma diturinë«. Kurse tjetri vërsel thekson: **Ve fevka kul-lu dhi ilmin alimun.**

»Mbi çdo dijetar ka më të ditur«.

Nga fjalët e lartëshnuara shohim se Islamizmi nuk e kufizon kërkimin e diturisë, por jemi të detyruar ta kërkojmë kudo dhe kurdo. Hadithi vijues na sqaron këtë thënjë: **Utlubul ilmi minel mehdi ilel-lehdi.**

»Kërko diturinë prej djepit gjer në varrë«. Mirëpo këte detyrë e shohim edhe nga ky hadith: **El hikmetu dalaletul mue mini ejnema vexhedeha ehadheha.**

Mençuria (dituria) është gjë e humbur e besimtarit, kudo që e gjen le ta merr«. Kurse hadithi i parë tregon se në kërkimin e diturisë nuk ndikon as mosha as gjë tjetër.

Më lartë vërejtëm se në kërkimin e diturisë nuk mund të ndikoj as mosha, kurse në hadithin vijues vëjmë se për kërkimin e diturisë nuk mund të ndikojë as vendi, largësia e tij, lidhja me këtë pejgamberi a. s. thekson: **Utlubul ilme ve lev kane fis-sini.**

»Kërkone diturinë qoftë ajo edhe në Kinë«.

Të gjitha këto këshilla islamizmi nuk ia drejton vetëm mashkullit, por edhe femrës. Këtë e vëjmë nga hadithi pasues: **Talebul ilmi Ferida Ala kul-li muslimin ve muslimetin.**

»Kërkimi i diturisë është obligim për çdo musliman dhe muslimane«.

Zoti xh. sh. ia parashtron diturinë mbarë njerëzisë, por asaj më së miri do t'i përgjigjen dijetarët siç e shohim nga vërseli i ardhshëm: **In-nema jahshall-lahe min ibadihil ulemae.**

»Me të vërtetë i frikohen Perëndisë prej robëve, dijetarët«. Kurse në versetin tjetër theksohet: **Vet-tekuni ja ulil el babu.**

»Frikësohuni nga Unë o të mençur« Shkenca na jep dituri, kurse feja ideal të lartë dhe sa vjen e zgjerohet ky horizont, rritet edhe ngjenja e urrejtjes ndaj jo diturisë. Njeriu sa më shumë që dinë aq më shumë

vlen. Kur'ani e don besimtarin kuptues, të cilin e përkrah dhe e nxit në suksese të reja. Kur'ani iu është kushtue njerëzve kuptues të cilët e kuptojnë dhe ato i manifestojnë në jetën e përditshme. Kur'ani thekson: **Huda ve dhikra li ulil el babi.**

»Udhëzimi dhe përmendja (vërejtja) janë vetëm për të kuptuarit«.

Shkenca u jep njerëzve dituri dhe material për ta sunduar gjithësinë, kurse feja u jep njerëzve edukim psikik dhe fuqi për ta sunduar vetveten. Në hadithin vijues Muhamedi a. s. na këshillon në këtë mënyrë: **La-jestevisih-shejhu ev jeteal-lemul ilmu kema jestehaebeden jekulul hubzu.**

»Mos të frikohet plaku të kërkoji dituri, sikur që nuk turpërohet me ngranë bukë gjithmonë«.

Mirëpo, ka të tillë që nga kushtet ekonomike, social e nuk kanë mundësi të shkollohen, por atyre u këshillohet të dëgjojnë ligjrata apo ta simpatizojnë gjegjësisht te ta lavdrojnë ate. Këtë e shohim më së miri në këtë hadith: **Kun alimen ev muteal-lime ev mustemain ev mim-ma fala tekun el-hamisatu fetuhlike.**

»Bëhu dietar ose nxënës ose dëgjoji dietarët ose bëhu simpatizues i tyre, e mos u bënë i pesti se do të humbesh«.

Këtë fakt disa ia mbështetin islamizmit. Pas të gjitha këtyre imperativeve si mund të jetë islamizmi i prapambetur, pasi që ai kërkon progres dhe arsimim.

Në mesjetë duke filluar që nga shekulli 11 kisha me konceptonet e saja dekadenciale mendohej t'i ruajë interesat e saja nëpër masën e gjërë dhe kështu dënonte çdo akt të dietarëve. Shembull të tillë kemi dënimin e Gjordanos Brunos, Galile Galileut etj. Kjo ishte epoka në të cilën shkenca stagnoi dhe përjetoi mendimet më të mëdha.

Duhet t'u jemi mirënjohës dijetarëve të parë të cilët i njeht bota intelektuale si: Ibni Sinau (AVICHENA), Kindiu, Farabiu, IBNI Rushdi, Ibni Betuta e shumë të tjerë.

Të gjitha thënjët e lartëpërmendura na flasin mbi rëndësinë e diturisë në përgjithësi. Si përfundim në këtë temë theksojmë imperativin e Perendisë: **Ikre bismi rab-bi kel-ledhi halek. Halekal insane min alek. Ikre ve rab-bu ke l ekremul-ledhi al-leme bil kalemi. Al-lemel insane ma lem jaë lem...**

»Lexo, studjo, gjurmo në emër të Zotit, i cili krijoi gjithçka. Ai e krijoi njeriun prej spermës. Lexo, Zoti yt është më i përsosuri, fisniku. Ai e mësoi njeriun ta përdor lapsin (pendën).

Ai i mësoi njeriut edhe ate që njeriu nuk e ka ditur.

Sherif Ferati kl. V.

PEJGAMBERËT — TË DËRGUARIT

Njerëzit vështruan gjithçka rreth vedi, vështruan hapsirën dhe trupat në te, vështruan të gjitha krijesat dhe më në fund u binden se çdo gjë në natyrë luan një rrol të posaqëm, kryen një detyrë të rëndësishme. Pas këtij vështrimi filluan të mendojnë për shpikësin e këtyre sendeve i cili me plotë dije e urti krijoi çdo send, gjithçka të planifikuar për një qëllim të caktuar, asgjë e kotë, e në mesin e këtyre krijesave e gjeti edhe vedin, si krijesë më e përsosur.

Ky njeri i përsosur me të menduar u kënaq kur e pa vedin se gjendet në shkallën më të lartë të krijesave, madje kur e kuptoi se është udhëheqës i të gjitha sendeve e krijesave në këtë botë, kur vërejti se atij i është dhënë mundësia që t'i shfrytëzoi të gjitha begatit e kësaj bote etj. Mirëpo, nga kjo kënaqësi i lindi ndjenja e rrespektit, adhurimit, falënderimit ndaj atij që i bëri të mundur të gjendet në shkallën më të lartë, e për të mos u pshjellur rreth asaj se çfar obligimi ka ndaj atij që i dha gjitha këto të mira, si duhet rrespektua, adhuruva lutë dhe afrua atij, Zoti xh. sh. i dërgoi pejgamberët ashtuqë edhe në këtë lëmi të ju ndihmojë, të mos hutohen, të mos pshtjellohen, por në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme ti shprehin falënderimet Krijuesit të tyre

duke praktikua urdhërat dhe largua nga ndalimet që nuk kanë tjetër qëllim vetëm dobinë e njeriut.

Sa po shihet, të dërguarit kanë patur për detyrë të ndihmojnë njerëzinë në të gjitha lëmitë e jetës e edhe në ate të adhurimit dhe falenderimit, për ndryshe flijimet do të bëheshin të pa logjishme, sikurse ka nga dhe ngjanë ndër ihtarët e besimtarëve të fenave të shpikura nga vetvetiu, e jo prej Zoti.

Vërtetë edhe Kur'ani, fjala e Zotit na e bënë edhe më të qar këte që e tham kur thotë: **»E fehasibtum enema haleknakum abethen ve enekum ilejna la turxheunë, fe telallahu el melikul haku, la ilahe ila huve rabul arshil kerimë!«** që do të thotë: A menduat se ne ju krijuam juve pa qëllim (shkel e shko) dhese ju nuk do të vini — riktheheni ke ne, larg asaj është Allahu, sunduas i vërtetë, nuk ka zot tjetër përveç tij, ai është mbikëqyrës i arshit të famshëm!.

Mbi të dërguarit e Zotit është folë edhe herave tjera se disa prej tyre ishin »Nebij« e disa të tjerë »Resul«, sipas mendimit të atyre që vërtetojnë se ka dallim mes këtyre dy termineve, rrespektivisht emërimeve.

Këtu është me rëndësi të përmendi çështjen e të dërguarve dhe në mënyrë analitike të kuptojmë se çka dua me thënë me këtë. Të dërguar të Zoitt janë ata njerëz të cilët nëpërmjet Xhibrilit pranojnë mësimet e Zotit, e këtij mësimi në këtë mënyrë i thu-

het »Vahj« — inspirim etj. dhe pranimi i kësaj mënyre të mësimit ndër pejgamber është e vetmja bazë, i vetmi themel në të cilin vëhet e vërteta mbi »Dergatën — Risalen« dhe mbi të gjithë pejgamberët dhe ky mësim është i vetmi burim i besimit, rregullave të tij dhe i vetmi burim i të gjitha çështjeve sekrete. Ky mësim nuk është rezultati i studimit a përvojës, i angazhimit të thellë mendorë, por është vetëm trazimet i atyre mësimëve që i dedikohën prej Zotit duke mos shtua e as mungua asgjë nga ato. Andaj nuk duhet ngatrrua »Vahjin« me aftësitë, talentin, inteligjencën etj. ngase të gjitha këto janë veti e virtyt i personalitetit njerëzor, por nuk janë »Vahj«. Mësimet që na i solli Muhamedi nuk janë rezultat i aftësive të tij mendorë e intelektual, edhe pse ai ishte mjaftë i urtë, por janë udhëzime të fituara nga i madhi Zot xh. sh.

Në Kur'an flitet shumë mbi pejgamberët, mbi jetën dhe biografinë e tyre, mbi problemet dhe vështësitë që patën gjatë jetës së tyre etj. por këto nuk duhet kuptua vetëm si tregime dhe ngjarje historike, këto kanë qëllim edukativ me anën e së cilave Muhamedi në rend të parë e pastaj edhe besimtarët do të përfitojnë përvojë në punën dhe jetën e tyre të mëtejme.

»Ve kulen nekussu alejke min enbair rusuli ma nuthebitu bihi fuadeke ve xhaeke fi hadhil haku ve mevidhatun ve dhikra lil muminin«. Të gjitha ato që të tregojmë nga lajmet mbi pejgamberët duam të përforcojmë zemrën tënde dhe në to e gjenë të vërtetën pasi që janë këshilla e përkujtime edhe për besimtarët.

Huazua prej lëndës së akaidit
Zejnullah Jusufi kl. IV

EDUKIMI ISLAM I RINISË SONË

Prej detyrave më primare dhe më të rëndësishme në islamizëm është edukimi i rinisë në frymën islame. Angazhimi jonë në këtë fushë duhet të jetë i përhershëm dhe i domosdoshëm, të nesërmen të kemi një rini të shëndosh. Si bazë për edukimin e një rinie të tillë është edhe edukata Islame. Morali dhe niveli i kulturës së tij, varet prej edukimit të pastër dhe të bukur Islam. Islamizmi është porosi, dhuratë e madhe dhe e shenjtë, të cilën porosi duhet dhuruar brezit të ardhshëm. Por, me kusht që t'i dorëzohet brezit të ri, i cili është i gatshëm ta pranojë këtë porosi. Prandaj, nëse nuk interesohe mi për të pasur një rini të shëndoshë dhe të edukuar në frymën Islame, atëherë nuk do të kemi kujë për të ia besuar një porosi të tillë. Prandaj, detyra e të rriturve muslimanë është mjaftë e rëndë. Të rinjtë nuk janë fajtorë, nëse ata nuk janë të udhëzuar me kohë në rrugë të drejtë — me një edukim të pastër Islam. Këtë e shohim nga ky hadith i Muham-medit a. s.

Kul-lu mevludin j-uledu ala fitretil islami fe chevahu juhev-vidanihi ev junes-siranihi ev jumexh-xhisanihi.

»Çdo i lindur është i lindur në frymën Islame dhe (është i gatshëm për ta pranuar fenë ISLAME), e pastaj prindërit e Tij e bëjnë ate ebrej jehud), krishter ose zjarrputist«. Nga hadithi i lartëshënuar shohim se fëmiu do ta pranojë ate çka i paraqet prindi, dhe ajo rrugë ka për ta udhëhequr tërë jetën e tij, nëse është rrugë e keqe ka për ta shpie drejtë shkatërimit të vetvetes dhe shoqërisë. Për këtë shkak edukimi i fëmiut është një përgjegjëje e madhe për prindërit. Këtë shumë bukur e paraqet Muhamedi a. s.: **Kul-lukum rain ve kul-lukum mesulun an reij-jetih**

»Secili prej jush është rojtar dhe secili prej jush do të përgjegjëjet për rojen e tij«.

Nga ana tjetër, nëse prindi e edukon fëmiun në frymën Islame, dmth. e edukon siç duhet, atëher prindi i ka dhuruar fëmiut të vet pasuri më të madhe dhe më të vlefshme që egziston, sepse më shumë vlen edukimi i mirë se sa pasuria e madhe. Ja se çka ka thënë Pejgamberi a. s.: **Ma neha le validun an veledihi efdalu min edebin hasenin**

»Nuk mundet një prind që t'i dhuroj fëmiut të vet asgjë më të mirë se edukimin e mirë«.

Nga këto fjalë do të vëjmë se çfarë kujdesi duhet të ketë prindëri ndaj fëmiut.

— Faza e parë është faza e hershme, fëminore, ku prindërit e luajnë fjalën kryesore.

— Faza e dytë është koha e rinisë dmth. koha kur ai shkollohet koha e mësimi. Ai në këtë kohë pajiset me dituri të vlefshme dhe përgaditet për të ardhshmen e tij. Përpas prindërit rol të rëndësishëm në edukimin e një të riu e luan edhe mësuesi.

Aleksandri i madh ka qenë nxënës i filozofit të shquar grek, Aristotelit. Leka i madh ka qenë edhe sundues i madhë, përveç asaj edhe edukator i mirë... Ja se me çfarë fjalësh i falenderon prindërit dhe mësuesin.

»Babait tim i falenderohem që jetoj fiziolgjikisht, kurse mësuesit (edukatorit) i falenderohem që jetoj si njeri i mëbrim«. Nga këto fjalë shohim se sa ky sundues i madh i falenderon prindërit dhe mësuesit, të cilët i kanë dhënë edukatë të mirë dhe kulturë të gjërë. Fëmiu përveç nevojës që ka për një zhvillim fizik, dhe nevojës së përfitimit të një edukate të shëndoshë, ai duhet të pajiset edhe me dituri më bashkohore ashtu që të mos ngelë mbrapa e zhvillimit të përgjithshëm. Koha ndryshon; shkon njëra vjen tjetra, pa tjetër duhet jetuar në kushte krejtësisht të ndershme. Prandaj, duhet paraparë çdo gjë që mund të vjen, dhe të gatshëm ta presim të ardhshmen. Aliu r. a.,

i cili pas vedi ka lënë shumë aforizma ka thanë: **Edebu-u ev ladekum ila gajri zemanikum**

»Edukoni fëmijët tuaj në atë kohë, kur ata jetojnë« (E jo si pas atyre metodave dhe mënyrave praktike, të cilat kanë sunduar në kohën e fëminisë dhe rinisë suaj).

Sot duhet ta falemenderojmë Zotin që në vendinë tonë gjenden institucione të tilla sikurse janë medreset në Prishtinë dhe Sarajevë, ku gjeneratë pas gjenerate kalojnë nëpër to, dhe do të jenë në gjendje ta për-

ballojnë çfardo problematike që do t'ju paraqitet në jetën e tyre.

Nëse jemi në gjendje që në këtë mënyrë t'i edukojmë fëmijët tonë, nëse jemi në gjendje ta edukojmë një rini të shëndosh, atëherë nuk duhet të frikësohemi për të ardhmen e këtij emaneti të shenjtë, gjegjësisht për të ardhmen e Kur-anit, për të cilën nuk e pranuan as qiellrat e a stoka, as malet, por i vetmi njeriu. (Jo në kuptimin bukfal të fjalës).

Shaqir Fetahu kl. IV

KUSH ISHTE LLUKMAN EL-HAKEMI

Në islamizëm dhe në literaturën e përgjithshme të lindjes së Afrërt shpesh hasim në emrin e dijetarit të shquar Llukman Hakimi, apo siç e quan bota islame »Llukman i shquar«.

Disa historianë thonë se ky ishte besimtar i fesë së vërtetë dhe njeri xhëntelmën, mirëpo shumica thonë se fjala është për mjek, i cili ka jetuar para ardhjes së Muhamedit a. s.

Për Llukmanin na dukumenton edhe Kurani ku në kaptinën »Llukman« theksohet:

»Me të vërtetë Llukmanit ia kemi dhënë zgjuetsinë«. Në këtë kaptinë dhe versetet që vijnë, shihet se Llukmani me këshillat dhe vërejtjet që ia jep djalit të vet ka qenë njeri i mençur dhe xhëntelmën.


Ibni Xheriri rrëfen një ngjarje nga jeta e Llukmanit:

Derisa Llukmani ishte rob, zotriu i tij e urdhëroi që t'i sjellë gjymtyrët më të mira të mishit. Llukmani e dëgjoi e preu delen dhe ia dërgoi zotriut të vet, zemrën dhe gjuhën. Herën e dytë zotriu i tij përsëri kërkoi që Llukmani ta presë një dele dhe të ia sjellë pjesët më të këqia. Përsëri Llukmani ia solli zemrën dhe gjuhën. Për këtë gjest zotriu e pyeti; si zemra dhe gjuha janë pjesët më të mira dhe njiherit pjesët më të këqija. Ai iu përgjegj:

Nuk ka as gjë më të mirë se zemra dhe gjuha kur janë të mira, por s'ka më të këqija kur zemra dhe gjuha nuk janë të mira. E pyetën Llukmanin se si e ka fituar gjithë atë dituri, ai ishte përgjegjur:

— E kam tubuar prej të paditurve, sa herë kam shikuar vepër të gabuar kam mësuar që ashtu mos të veprojmë.

MUHAMED MUSTAFA KL. II



HADITH

An ebi hurejrete radijallah anhu en-ne Resulall-lahi alejhi selam. Kale: men kane ju' minu bil-lahi vel jevmil ahiri fel jekul hajren ev lijesmut ve men kane ju' minu bil-lahi vel jevmil ahiri fel jukrimu xharehu ve men kane ju' minu bil-lahi vel jevmil ahiri fel jukrimu dajfehu. Revahul Buharij ve muslim.

»Nga ebu Hurejra r. a. se peygamberi a. s. ka thënë? »Ai i cili i ka besuar Zotit dhe ditës së gjykimit le të flet mirë ose le të hesht, kur se ai i cili i ka besuar Zotit dhe ditës së gjykimit, le ta rrespektojë mysafirin e tij:«

Sqarimi i hadithit të lartshënuar:

Këtë hadith mund ta ndajmë në tri pjesë kryesore:

1) Para së gjithash Peygamberi i këshillon besimtarët që kur të diskutojnë le të diskutojnë për ate çështje prej të cilave ka dobi, përndryshe, le të heshtin. Le të diskutojnë qartë duke mos gënjeshtuar, shpifur, shkurt të ruhemi nga çdo gjë e keqe. Edhe në Kur'an jemi të urdhruar të largohemi nga gjërat e këqija. Një ajetë i Kur'anit thekson: **In-nema jefteril-kedhibel-ledhine la juëminune bi ajetil-lahi**

»Me të vërtetë shpifin rrenën (bëjmë gënjeshtër) ata të cilët nuk besojnë në argumentet e Zotit xh. sh.«.

Përej këtij ajeti kuptohet se rrena është cilësi e pa besimtarit, e as sesi cilësi e muslimanëve të vërtetë.

Peygamberi a. s. në lidhje me rezultatet e atyre personave, të cilët nuk e kontrollojnë gjuhën e tyre çka flasin, ka thënë: **Hel jekubbenen-nase fin-nari ala vuxhuhihime il-la hasaide-el sinetihim.**

»Nuk u gjuanë njerëzve askush zjar në fytyrat e tyre, pos rrezultatit të korur me gjuhën e tyre.«.

2) Pjesa e dytë e këtij hadithi të lartshënuar flet për shitjen dhe të drejtat që i gëzon fqiu prej fqiu; në një hadith shohim ku Peygamberi a. s. thotë: **Ma zale xhibrili jusini bil-xhari hat-ta dhanentu en-nehu sejurithuhu.**

»Vazhdoi xhibrili duke më këshilluar mua në lidhje me fqin sa që mendova se ai do të trashëgojë atë (do të ketë trashëgim në pasurinë e fqiu të tij)«.

Fqinjët në Islamizëm janë tri kategorishë, sipas të drejtës dhe rrespektit që gëzojnë ata:

a) Në kategorinë e parë bënë pjesë fqiu i cili është musliman nga farefisi. Kjo kategori fqinjësh gëzon tri të drejta:

— Të drejtën e islamizëmit — si muslimin; — të drejtën e farefisit — si të afërt dhe më në fund të rejtën e fqiu — si fqijë.

b) Fqiu i cili është mysliman, por nuk është prej farefisit; të tillët gëzojnë dy të drejta:

— Si musliman dhe të drejtën si fqinjë.

c) Fqiu i cili nuk është mysliman dhe nuk është prej farefisit, ai gëzon vetëm të drejtën si finjë.

Në një rast, e pyetën as'habët Peygamberin a. s. se cili është fqiu më i afërt? Muhamedi a. s. iu përgjeggj:

»Fqiu më i afërt është ai të cilin e ke në megje«.

3) Çështja tjetër është e zbrthyeme në hadithin e lartshënuar është respektimi ndaj musafirit. Sa i përket mysafirit dhe atij i cili gjendet në rrugë, Zoti xh. sh. ka urdhruar që udhtarëve t'u dilet në ndihmë, po ashtu edhe Peygamberi a. s. ka urdhruar që udhtarëve t'u dilet në ndihmë dhe të iu bëhet një rrespekt i duhur. Buhariu thotë se Muhamedi një ditë dikush i kishte sjell qumsh të në shtëpinë e tij, në atë rastë Peygamberi a. s.; e urdhroi Ebu Hurejren që t'i thëret udhtarët të cilët, kishin mbetur pa ushqim. Ebu Hurejra i thiri udhëtarët, e Peygamberi a. s. ua mbushte gotat me ushqim, i përcillte prej njërit në tjetrin deri sa pinë të gjithë pastaj i dha Ebu Hurejres dhe më në fund piu vet.

Sa i përket rrespektimit të mysafirit dalja në ndihmë udhëtarëve të ndryshëm jemi të urdhruar si në Kur'an ashtu edhe me hadithetë Peygamberit; mirëpo sipas mendimit të dietarve muslimanë, thonë se në ditën e sotme posaçërisht nëpër qytete ku egzistojnë hotele dhe bujtina të ndryshme, nuk është e detyruar që ti bësh konak çdo kujt, por varësisht nga mundësitë mund t'u bëhet strehim, po nëse nuk ka mundësi t'u bësh strehim, atëher të gjithë myslimanët janë të obliguar që t'i bëjnë atij myslimani strehim, e në se dikush e merr për sipër këtë detyrë, të gjithëve u largohet obligimi.

Nga lënda e hadithit.

Zeqir Hamza kl. V.

فَالرَّسُولُ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ * مَكَةَ حَرَمِ أَبِي إِبْرَاهِيمَ * وَالْمَدِينَةَ
حَرَمِي * وَأَنَا الْحَرَمُ مَا بَيْنَ لَابَتَيْهَا * صَدَقَ رَسُولُ اللَّهِ .

Bota e gjallesave të padukshme

Në botën e pa dukshme aq sa kuptojm prej Kuranit janë melaiket dhe xhinët, megjithë ka sheja po në Kur'an se ka edhe krijesa të tjera sikur që thuhet: **Ve jahlu ku ma la' ta'alemun...**

»Zoti ka krijuar edhe çka nuk dini ju«.

Melaiket janë krijesa të përsosura të cilat gjithnjë adhurojnë, respektojnë, përulen dhe kur nuk e thejnë urdhrin e Zotit.

La ja'sunell-llahe ma emerehum ve jefalune ma juëmerunë.

»Nuk kundërshtojnë Zotin në atë çka i urdhron dhe nuk e thejnë urdhrin e Tij«. Natyra e tyre në pikëparje të zhvillimit të tyre fizik dhe mendor është tjetër nga ajo e njeriut, ngase njeriu përjeton etapat e zhvillimit si në pikëparje fizike ashtu edhe në atë mendore. Zhvillimi mendor i njeriut përjeton etapën e foshnjëris, rinis, pjekurisë dhe të pleqrisë. Njohurit e tija i shton, i shumon në saje të mësimeve, studimeve, përvojës etj. E kjo veti e zhvillimit mendorë nuk gjendet ke melaiket ngase atyre njohuritë iu dhuron Zoti drejtëpërdrejtë dhe në mënyrë të kompletuara që do të thotë nuk kanë ato fazat e zhvillimit si që bën njeriu, dhe mu këtu qëndron arsyeja pse ato nuk munden ta kuptojnë rrolin e njeriut si halife në tokë, kur publikoi Zoti xh. sh. se do të krijoj një qenie nga uji dhe balta në planetin e tokës qenie e cila do të udhëheq në ate planet.

Melaiket janë të krijuara prej elementit të dritës, e njeriu si qenie fizike e planetit të tokës nuk është në gjendje ti njofë apo ti kuptoi ato. Këtu nevojitet besimi në egzistencën e tyre sikur që na mëson Kur-ani, përndryshe këto bëjnë pjesë në çështjet sekrete të cilat nuk i nënshtrohen ndonjë studimi a përvojë.

XHINËT — Edhe bota e xhinve është e pa dukshme. Për xhinët thuhet në Kur'an se janë të krijuar prej elementeve të forta; andaj edhe kushtet e jetës së tyre janë po në atë materje prej së cilës janë krijuar. Në Kur'an thuhet: **Vel xhan-ne haleknahu min kablu min-naris-sumumi**

»Që do të thotë: Xhinët i krijuam më parë prej zjarit me temperaturë shumë të lartë. Fjala »SEMUMI« do të thotë: nxehtësi me temperaturë aq të lartë që ka fuqi depërtimi në çdo sendë tjetër. Në një vendë tjetër në Kur'an thuhet: **Ve halekal xhan-ne min marixhin min-narin**

E fjala »MARIXHIN« do të thotë: zjarë i fortë që mer ngjyrën e kaltërtë. Edhe këtë botë të xhinve shqisa e njeriut nuk është në gjendje ta përjetoi pse edhe kjo bënë pjesë në ate sekrete.

Xhinët mund ta shofin njeriun ndërsa ai jo, derisa ata janë në strukturën e krijuar. Edhe pse bota e melaikëve dhe e xhinve janë apstrakte dhe edhe pse janë çështje që i takojnë besimit, bota bashkohore, e veçanërisht ajo e shekullit XX pas zgjerimit të njo-

hurive shkencore dhe hulumtimit të vazhdueshëm në kosmos, është në pranim e sipër se në planetet me temperaturë shumë të lartë egzistojnë krijesa që mund të jetojnë në ato kushte. E këto studime dhe hulumtime nuk janë gja tjetër vetëm se vërtetim i thënies së lartë të Kur-anit.

A është shejtani nga xhinët gjersa edhe ai është i krijuar prej zjarit sikur që përmendet në Kur'an, për kundërshtimin që e bani ndaj urdhërit të Perendis për t'ju përkulur Ademit a. s. e thuhet.

Kale: Ene hajrun minhu halekteni min-narin ve halektehu min tin

»Ka thanë: unë jam më i mirë prej tij, më krijove prej zjari e ke krijuar ate prej dheut«.

Xhini-iblisi-shejtani

Sipas thënies të Kur-anit kemi kuptuar se melaiket me respektë pranuan urdhrin e Zotit dhe ju përulën Ademit, kuptohet në shej respekti e jo adhurimi sikur që mund të kuptohet nga fjala »FESEXHEDU«.

Për xhinët msuamë se janë krijesa të obliquara sikurse njerëzit. Në Kur'an hasim në shprehjen IBLIS dhe SHEJTAN dhe gjithnjë kur përmenden këto shprehje tërhiqet një lloj vërejtje prej rezikut të tyre për njeriun.

IBLISI përmendet vetëm në ato vende kur thiren melaiket me iu përkulur Ademit dhe paraqitet si refuzues i urdhrin të zotit, e duke konsideruar vedin më të lartë nga se ishte krijuar nga zjari e Ademi nga dheu. Që disa shembuj të Kur-anit: **»Ve idh kulna lil melaiketis-xhudu li ademe fe sexhedu il-la iblise eba vestekbere ve kane minel ka-firine«.**

Lemjekun mines-saxhidine

Kale e esxhudu limen halekte tinen.

Kane minel xhin-ni fefeseka an emri rab-bihi.

»E kur iu tham melaikëve përkuluni Ademit, menjherë iu përulën vetëm Iblisi jo, refuzoi dhe bëri mendjemadhësi dhe ishte prej mohuesve.

Në tri ajetet e para nuk përmendet shejtani as xhin-ni, andaj mund të mendojmë për Iblisin se ka cilësi të posaçme prej shejtanit dhe xhinnit. Në ajetin e fundit paraqitet sikur që Iblisi ishte nga xhin-nët. Madje në Kur'an fjala shejtani, në njëse përmendet në 68 vende, ndërsa në shumës në 21 vendë. Në të gjitha këto vende tërhiqet vërejtja prej rezikut të tij sikur që thuhet në një ajet: **In-nesh-shejtane kane lil insani aduv-ven mubina**

»Vërtet shejtani është armik i hapët për njeriun«. Kjo armiqësi mes shejtanit dhe njeriut është vazhdim i armiqësisë së Iblisit që e bëri kundër Ademit për shkak se edhe e mallkoi Zoti.

Këtu sipas këtyre shënimeve po duket sikur që shejtani, iblisi janë dy emëra të një personaliteti, pse sikur që po njihet Iblisi me ato anë negative të mallkuara, njashtu edhe shejtani paraqitet si figurë e keqe e shumëtuar dhe e rezikshme.

Mirëpo, në anën tjetër duket se Iblisi ishte nga xhin-nët. Gjithashtu sipas një citati të Kur-anit Iblisi duket si me qenë prej melaikëve, ngase urdhëri i Zotit ju drejtohet Melaikëve të cilat e kryejnë atë, e vetëm Ky jo. Shih ajetin: **Fesexhedul melaiketu kul-luhum exhmeune il-la iblisi eba en je-kune mines-saxhidine.**

E nga ky ajët »istithnaja duket se është Mutasil. Në bazë të kësaj analize mund të na parashatrohet çështja e Iblisit si

a) Genie që ishte nga melaiket.

b) Genie që ishte në shkallë ma të ulët prej melaikëve dmth. në shkallën e xhinve, megjithëqë kanë ngajshmri në mes tyre, nga se të dy palët janë të krijuara prej zjarrit, por shkalla e melaikëve është ma e lartë, pse brumi i tyre është »NUR« e brumi i xhinve është »NAR«. Gjersa zjari është i përzier me tymë përveç dritës në te ka edhe erësirë, andaj edhe ndër xhinët kemi të hajrit dhe të sherit sikur që shifet në këtë Ajët:

Ve in-na minel muslimune ve min-nel kasitune fe men esleme fe ulaike tehar-ru reshe-den ve emel kasitune fe kanu lixhehen-neme hataben

»Vërtet nga ne ka besimtar dhe jo besimtarë, e ata që ju dorzuan Zotit gjetën shpëtimin, ndërsa ata që qëndruan kokfortë janë lëndë djegëse për xhehen-nem.

c) Iblisi gjithënjë ishte në grupin e xhinve ishte xhin, por kur e mallkoi Zoti e nxori prej grupit të xhinve dhe e quajti »Iblis« (i larguar i dëbuar).

q) Pasi që u nxuar prej grupit të xhinve dhe u mallkua u shndrua në genie tjetër dhe filloi të quhet »Shejtani rehim«, shejtani merid etj. e që jep me kuptuar për një fuqi prej së cilës burojnë të gjitha të këqiat dhe ato e godasin çdo person që i bashkohet asaj fuqie. Sa mundë të kuptohet ky ishte nga bota e xhinve, u shndruar në Iblis për kokfortësin që bëri ndaj urdhrit të Zotit, u shndrua në shejtani për armiqsin që e publikoi haptas kundër njeriut.

All-llahu aëlemu

Huazuar nga »Akaidi Shaqir Fetahu dhe Zejnulla Jusufi kl. IV.

Prof. Dr. ITALO CHIUSSI

Për Kur-anin Kerim

Para 9 vitesh nga shtypi duel përkthimi i parë »Esperant« i Kur-anit kerimit. E përktheu prof. dr. Italo Chiussi, me prejardhje nga Trieshta. Që nga viti 1957 jeton dhe vepron në Frankfurt të Majnes në R. F. Gjermane.

Fletushka »HEROLDO de ESPERANTO«, i kushton një rëndësi të posaçme këtij Kur-anit kerim.

Në një intervistë me disa gazetar u përgjegj në pyetje të shumta. Ja disa nga këto:

— Sa kohë keni shpenzuar gjatë përkthimit?

»Për përkthim kaluan vetëm 8 muaj, por gjer sa e studjova kaluan 3 vjet. Pyetja tjetër ishte:

— A dallon Kurani juaj nga të tjerët?

»Gjatë punimit kam pas një rrespekt të plotë ndaj Kur-anit. Përkthyesit jo muslimin nuk kanë rrespekt ndaj tij, por sillen sikurse me tekstet tjera. Shumë të tjerë e humbin vlerën dhe estetikën e tij duke mos e njohtë gjuhën mirë.

Pyetja tjetër ishte: — Muhamedanët mendojnë se Kur-ani është origjinal, i pa prekur, siç ka zbritur nga Zoti. A e pranoni ju kështu mendim.

»Para së gjithash u kisha këshilluar që t'i largoheni shprehjes »Muhamedan«, kur mendoni të flitni për muslimanët. Besimi islam është rrepsishtë dhe ekskluzivishtë

monoteiste kurse Muhamedi është pranuar i dërguar i Zotit, e jo ndonjë genie e lartë që duhet adhuruar. Për historinë e Kur-anit do tu përgjigjesha me mendimin e shumë orientalistëve më autoritativë se unë, si kurse MUIRI, i cili dëshmon pakontestueshëm se Kur-ani sot ka të njejtin tekst të cilin e ka pas edhe para 1400 vitesh.

Kisha thënë pa kurrfarë dyshimi se ka të bëjë me një fenomen unitar, nga se për asnjë libër tjetër, kur i përjeton disa botime, sigurishtë do të pëson ndryshime. Ja mendimi i priftit katolik jezuit, me të cilin jemi shok të mirë dhe shkëmbejmë letra. Pasi ia bëra pyetjen se ç'mendon për Muhamedin, a egziston mendimi i shekujve të mesëm, tha: i paraqes pikë për pikë fjalët e shkruara në letër: »Është e mundur dhe ate sigurishtë që kontakti në mes Zotit dhe Muhamedit është fakt i pa mohuar;...« Atij iu bënë edhe pyetje tjera për të cilat u përgjigj.

Italo Chiussi shumë Kur-an të përkthyer të tij ia fali: Shahut të Iranit Kralitë të Arabisë Saudite, Egjiptit, Malezis, Indonezisë dhe një univerziteti El-Azhar të Egjiptit, me qëllim të përhapjes së Islamizmit.

Huazim nga zem-zemi.

Nexhat Ibrahim kl. V.

وَأَنْ هَذَا صِرَاطِي سَيِّمًا فَاتَّبِعُوهُ

BESIMTARI I VËRTETË

Besimtar i vërtetë
është ai njeri,
që beson në Zotin
dhe Pejgamberin e Tij.

E adhuron të Madhruarin,
namazin, çdo herë e falë,
zgjohet në mëngjez heret,
dielli ende pa dalë.

Në mesditë, kur dielli,
zevalin e kalon,
përgaditet ngadalë,
në namaz të shkojë.

Çdo gjë që është lejuar,
ai me të krenohet,
çdo gjë që është ndaluar,
ai prej saj largohet.

Rrugës drejtë gjithmonë
shkon ai njeri,
gjë të huaj nuk don,
dhe e ka shumë zili.

Nuk bënë aventurë,
askend s'e gënjen,
sepse i Madhruari,
atë shumë e vren.


Xhemil Sadiku Kl IV.

Të rinjët tan-gëzimet tona

Sikurse çdo vitë tjetër edhe kësaj radhe medresja i pëcrolli maturantët e gjeneratës së XII të cilët na japin me kuptuar se çdo vitë nga gjiri i kësaj shkolle të lavdruar dalin intelektual të ri të fesë islame. Këta nxënës të cilët e mbaruan shkollimin, disa prej tyre po vazhdojnë shkollimet e larta kurse disa prej tyre hynë në detyrë dhe e udhëheqin popullin në rrugë të islamizmit. Kjo prarverë ishte gëzimi i dymbëdhjetë shkollës sonë. Këte gëzim e shijon mbar populli islam i vendit tonë, por e shijon edhe shkolla jonë në krye me këshillin arsimor e udhëhequr nga drejtori i shkollës H. Sherif Ahmeti i cili me stëratëgjini e tij mendore e udhëheqë këtë.

Shkolla jonë është e kënaqur me sukseset që i aritën nxënësit tonë në lëmitë e ndryshme. Kjo gjeneratë erdhi saktë para pesë vjetësh, që të njoftohen me njeriun dhe zhvillimin e tij, që tërë jetën t'ia kushtojnë Zotit dhe fesë. Para plotë pesë viteve patën ardhur nga të gjitha viset, duke mos njohur njëri tjetrin.

Por koha e bëri të vetën, që ata në të ardhmen, të jetojnë një jetë vëllazërore dhe së bashku të luftojnë për sukseset e veta të mëtejme dhe për të nesërmen e tyre. Të tubuar nga të gjitha regjionet e vendit tonë, prej fillimit e gjer në mbarim, kanë kultivuar pëlqim dhe shoqëri gjer në ditën e fundit, ku këte të gjithëve ua kanë demonstrua.



Që të njihemi më mir me maturantët e këtij viti shkollorë 1978/79 po i paraqesim në formë të tabelës bashk me kujdestarin e tyre dhe duke i treguar me shenjat e fshat-

rave të tyre dhe komunave, e ai rendë i tabelës është apo e përmban këtë rregull:

Kujdestar i klasës RUZHDI SHABANI
fshati Kamenjan Tetovë

Emri e mbiemri i nx.	Fshati	Komuna
1. Abedin Thaqi	Kushnin	Prizren
2. Ahmed Rama	Prishtinë	Prishtinë
3. Aliriza Ajdini	Reçica e vogël	Tetovë
4. Arif Nesimi	Dobroshtë	Tetovë
5. Bexhet Ajvazi	Dumoshë	Podujevë
6. Ejub Krasniqi	Makovcë	Prishtinë
7. Enver Kosumi	Zhiti	Podujevë
8. Halit Haliti	Inatovcë	Gjilanë
9. Habib Hoxha	Blacë	Suharekë
10. Hamdi Izairi	Kamenjan	Tetovë
11. Hazbi Sulejmani		Tetovë
12. Idriz Idrizi	Miletin	Tetovë
13. Isa Memishi	Raincë	Preshevë
14. Kapllan Shefqeti	Kukë	Dragashë
15. Lutfi Bajrami	Stagovë	Kaçanikë
16. Mehdi Rama	Grdovc	Podujevë
17. Musadin Ajvazi	Radesh	Dragash
18. Muhamed Bilalli	Lisec	Tetovë
19. Naim Trnava	Lismir	F. Kosovë
20. Nexhat Ibrahim		Prizren
21. Nusret Holiq	Leskov	Tutin
22. Reshat Mexhiti	Kuklibeg	Dragash
23. Setki Skenderi	Kuk	Dragash
24. Sheval Azizi	Svillar	Tetovë
25. Sherif Ferati	Odri	Shkup
26. Vebah Aliu	Ranatovcë	Preshevë
27. Xhevat Krieziu	Gubavec	Klinë
28. Zeqir Hamza	Veshall	Tetovë

Të gjithë këta 28 maturanta mbaruan vitin shkollorë më 14 Maj 1979, duke festuar mbërëmjen e maturës mbajtën një ceremoni në xhami të madhe, ku na treguan suksesin

e aritur gjatë viteve të mësimi dhe i treguan popullit se feja islame kërkonë punë dhe zemërgjërsi.

Zejnullah Jusufi, kl. IV



Lexues të nderuar-vëllezër!

Për çdo herë të lexoni fletën
»NURË«

Na shkruani për përshtypjen e juaja

Nëse ju pëlqen, i porositni edhe të
tjerët ta lexojnë

Do të përpiqemi që këtë fletë ta
bëjmë sa ma të afërt për lexuesit
e nderuar

NURË s'pari për fëmiun e juaj,
për vëllaun, për mikun.



N U R Ë

E BOTON SHOQATA E NXËNËSVE TË MEDRESËS
»ALAUD-DIN« PRISHTINË

REDAKTOR KRYESOR DHE PËRGJEGJËS
ZEJNULLAH JUSUFI

E REDAKTON KOLEGIUMI:
SHAQIR FETAHU, SHABAN SULEJMANI, FADIL HASA-
NI dhe IBRAHIM MUSOLLI

FLETA DEL SIPAS MUNDËSISË

SHKRIMET I DËRGONI:
KËSHILLI REDAKTUES I »NURIT« PRISHTINË

Është lejuar botimi i fletës »Nurul Kur-an« me vendimin e Sekretariatit për informata të Kuvendit të KSA të Kosovës dhe Këshillit ekzekutiv, nr.01.650-64, të datës 18 mars të vitit 1975, në Prishtin

Shtyp Organizata për veprimtarinë grafike »Progres — Svetozar Gjorgjeviq« Mitrovicë